



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 322 Akti

Nr. 388 Vendimi  
Tiranë, më 20.5.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Firdes Shuli</b>	Kryesuese
<b>Etleda Çiftja</b>	Relatore
<b>Roland Ilia</b>	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datën 18.5.2020, ora 14:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Alfred Shehu, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.**

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## **KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Shehu dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT PROCEDURALE**

**1.** Z. Alfred Shehu është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

**2.** Z. Alfred Shehu, bazuar në nenin 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 12.11.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisioneret: Firdes Shuli, Roland Ilia dhe Etleda Çiftja.

**3.** Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31-33, të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; si dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj, sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016.

**4.** Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin e datës 12.11.2019, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Firdes Shuli. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

**5.** Trupi gjykues, me vendimin datë 29.4.2021, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Shehu, bazuar në relativitetin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar bashkë me nenet D, DH dhe E, të Aneksit të Kushtetutës; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit,

me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

**6.** Në datën 29.4.2021, përmes postës elektronike<sup>1</sup>, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, jo më vonë se data 12.5.2021; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative.

**7.** Në datën 12.5.2021, subjekti rivlerësimit, me anë të postës elektronike<sup>2</sup>, dërgoi shpjegimet dhe provat e tij në përgjigje të rezultateve të hetimit administrativ kryesisht.

**8.** Me vendimin e datës 14.5.2021, me anë të postës elektronike<sup>3</sup>, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Shehu, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Përmes postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej datë 18.5.2021, ora 14:30, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

**9.** Bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Shehu, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës, si dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**10.** Në datën 18.5.2021 u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqiti personalisht në seancë.

**11.** Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove, apo për shpjegime.

**12.** Z. Alfred Shehu, pasi dëgjoi relacionin, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

**13.** Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Shehu, duke u bazuar mbi të tria kriteret e rivlerësimit.

**14.** Seanca dëgjimore e datës 18.5.2021 u ndërpre, për të rifilluar në datën 20.5.2021, për shpalljen e vendimit.

**15.** Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 18.5.2021, subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Shehu, kërkoi konfirmimin në detyrë.

---

<sup>1</sup> E-mail datë 29.4.2021, ora 15:08 "Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin e rivlerësimit".

<sup>2</sup> E-mail datë 12.5.2021, ora 8:36.

<sup>3</sup> E-mail datë 15.5.2021, ora 13:07 – "Komisioni – Ftesë për t'u dëgjuan në seancë dëgjimore".

### III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

16. Subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Shehu, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

17. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

18. Sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: (i) ILDKPKI-ja është organ kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) DSIK-ja është organ kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit; (iii) KLGJ-ja është organin ndihmës për vlerësimin profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

19. Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>4</sup>, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

#### A. RIVLERËSIMI I PASURISË

##### A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

20. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Alfred Shehu, i cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të

---

<sup>4</sup> Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

**21.** Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2003 – 2016 dhe në datën 25.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar “Deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*”. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin,*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

#### **A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

**22.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”, të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI, nga viti 2003 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; si dhe (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit dhe, në vijim deri ditën e seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

**23.** Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

#### **Personat e lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që janë hetuar**

**24.** Për efekt të procesit të rivlerësimit, personat që janë hetuar si të lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, janë si vijon:

**24.1** Znj. I.Sh., bashkëshortja i subjektit të rivlerësimit – konsiderohet person i lidhur; znj. S.Sh., nëna e subjektit të rivlerësimit – konsiderohet person i lidhur me subjektin e rivlerësimit, pasi është e regjistruar në certifikatën familjare të subjektit; z. E.Sh., djali i subjektit të rivlerësimit – konsiderohet person i lidhur; znj. S.Sh., vajza e subjektit të rivlerësimit – konsiderohet person i lidhur.

**24.2** Znj. S.Sh., znj. R.A. (Sh.), znj. I.L. (Sh.), znj. L.Sh. (Sh.) dhe znj. E.S. (Sh.) – nëna dhe motrat e subjektit – konsiderohen persona të tjerë të lidhur si rezultat i dhurimit të shumës 200.000 lekë.

### **Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur**

#### **1. Apartament me sip. 105.2 m<sup>2</sup>, në Elbasan, me vlerë 5.167.424 lekë**

**25.** Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar – apartament me sip. 105.2 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, p. \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, Elbasan, blerë me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 19.4.2013, në vlerën 5.167.424 lekë, në bashkëpronësi. Si burim krijimi subjekti deklaron – shitjen e banesës së mëparshme, apartament nr. \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, p. \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, Elbasan, si dhe kursimet familjare. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>5</sup>.

**26. Faktet nga hetimi administrativ kryesisht** - në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar blerje banese me kontratën nr. \*\*\*, datë 19.4.2013, me adresë lagjja “\*\*\*\*”, Elbasan, vlera 5.167.424 lekë. Në seksionin “*Të dhëna konfidenciale*” deklaron se apartamenti me sip. 105.2 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*, është siguruar nga kursimet familjare, ndër vite, si dhe të ardhurat nga shitja e banesës së ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan.

**27.** Referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, ASHK-ja Elbasan<sup>6</sup> konfirmon se në emër të subjektit të rivlerësimit, është e regjistruar pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq \*\*\*, z. k. \*\*\*, e llojit apartament me sip. 105.2 m<sup>2</sup>, në bashkëpronësi me bashkëshorten I.Sh. Apartamenti është blerë nga subjekti i rivlerësimit me kontratën nr. \*\*\*, datë 19.4.2013, me palë shitëse shtetasin Th.B. dhe bashkëshorten E.U. me çmim 5.167.424 lekë (çmimi për është 49.120 lekë/m<sup>2</sup>), likuiduar jashtë zyrës noteriale. Sipas hartës treguese bashkëlidhur, ky apartament ka qenë në pronësi të shitësit Th.B., regjistruar në datën 19.7.2006.

**28.** Me anë të pyetësorit nr. 2, subjekti u pyet se përse kjo pagesë është bërë jashtë zyrës noteriale në kundërshtim me ligjin nr. 7829/1994, “Për noterinë” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë/Ministrisë së Financave nr. \*\*\*, datë 30.1.2012 dhe nëse kjo pagesë është kryer *cash* apo është depozituar në llogarinë bankare të shitësit/shitësve. Në përgjigje<sup>7</sup>, subjekti deklaroi se pagesa është kryer *cash*, menjëherë pasi me kontratën nr. \*\*\*, datë 18.4.2013, është shitur banesa e ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”. Mënyra e pagesës nuk është bërë me ndonjë qëllim dashakeq për të fshehur burimin e të ardhurave, por është bërë menjëherë një ditë pasi është shitur banesa e vjetër, shitje e cila, gjithashtu, është bërë *cash*.

---

<sup>5</sup>Dokumentacioni ligjor provues: harta treguese e regjistrimit; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 19.4.2013; vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. \*\*\*, datë 19.7.2012; harta treguese, plan rievimi, kontratë për privatizimin e banesës datë 28.6.1993, vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 5.7.1993, nga Zyra e Hipotekës; vendim nr. \*\*\*, datë 13.2.2001, në lidhje me trashëgiminë e shtetasit A.Sh.; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 20.1.2005; kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 18.4.2013; certifikatë për vërtetim pronësie e regjistruar në emër të shtetasit A.Sh. datë 2.2.2005, harta treguese e regjistrimit, kartela e pasurisë.

<sup>6</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.8.2017.

<sup>7</sup>E-mail datë 12.3.2021, ora 13:45.

Në rastin konkret, përgjegjësia për zbatimin e nenit 49 të ligjit nr. 7829/1994, “Për noterinë”, të ndryshuar (në kohën e transaksionit) dhe udhëzimit nr. \*\*\*, datë 30.1.2012, duhej të ishte e noterit dhe jo e palëve që merrnin pjesë në transaksionin në lidhje me pasurinë e paluajtshme.

**29.** Nga dokumentacioni i shqyrtuar në sistemin multifunksional të ZVRPP-së, rezulton se shtetasi Th.B., është pajisur me leje ndërtimi për objektin bodrum + 2 kate + 8 kate banesë në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan, subjekt ndërtues shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. Sipas ekstraktit tregtar shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me NIPT \*\*\*, figuron me ortak të vetëm shtetasin Th.B. DPPP-jë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.1.2020, konfirmon raportimin në emër të subjektit të rivlerësimit në datën 19.4.2013, sipas kontratës nr. \*\*\*, për blerjen e apartamentit me çmim 5.167.424 lekë, me palë shitëse shtetasin Th.B. Nga hetimi i Komisionit<sup>8</sup> rezulton se subjekti nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit me shtetasit Th.B., E.U. dhe shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.

**30.** Më qëllim analizimin e vlerës së blerjes së këtij apartamenti, si dhe nëse ka pasur apo jo ndonjë trajtim preferencial për subjektin, sipas udhëzimit nr. 1, datë 8.5.2013, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2013”, rezulton se vlera reale e tregut për këtë apartament përllogaritet në shumën 5.175.840 lekë ( $105.2 \text{ m}^2 * 49.200 \text{ lekë/m}^2$ ).

**31.** Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile<sup>9</sup> na informon se subjekti së bashku me familjen figurojnë të regjistruar me adresë vendbanimi rruga “\*\*\*\*”, nd. \*\*\*, h. \*\*\*, banesa nr. \*\*\*, Elbasan. Sipas deklarimeve të subjektit prej vitit 2013 dhe në vazhdim, banon në adresën: p. \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, ap. \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, Elbasan. Referuar kërkimit në *google maps*, rezulton që objekti ku jeton subjekti<sup>10</sup>, ndodhet në kryqëzimin e këtyre dy rrugëve dhe bëhet fjalë për të njëjtën adresë banimi.

### ***Në lidhje me burimin e krijimit***

**32. Burimi I - shitja e banesës së mëparshme të ndodhur në Elbasan** - në DIPP të vitit 2003, subjekti ka deklaruar apartament banimi (2+1), në lagjen “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, ap. \*\*\*, Elbasan, i ndërtuar para vitit 1990, të cilin e ka në bashkëpronësi me pjesë takuese 23.3%. Apartamenti me vlerë “4 milionë lekë”, ka si burim privatizimin e banesave shtetërore, si dhe pjesa e trashëguar nga babai.

**33.** Komisioni vëren se me kontratën e privatizimit, datë 28.6.1993, me palë shitëse Ndërmarrjen Komunale Banesave dhe palë blerëse shtetasin A.Sh., është blerë apartamenti 2+1, në vlerën 18.820 lekë, ndërtuar në vitin 1983, në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan, vërtetuar kjo me vërtetimin e pronësisë nr. \*\*\*, datë 5.7.1993.

**34.** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur vendimin nr. \*\*\*, datë 13.2.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së shtetasit A.Sh., ku përcaktohet se trashëgimtarët ligjorë të radhës së parë janë S., R., I., A., L. dhe E.Sh. Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti deklaroi se ka blerë pjesën takuese të bashkëpronësisë së nënës S.Sh. dhe të motrave R.A., I.L., L.Sh. dhe E.S. të apartamentit 2+1, me sip.  $70 \text{ m}^2$ , në vlerën 200.000

<sup>8</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 10.3.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

<sup>9</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.3.2021.

<sup>10</sup>Sipas fotografive në dosjen e dokumentacionit të shkarkuar nga sistemi multifunksional.

lekë. Në seksionin të dhëna konfidenciale deklaroi se në janar të vitit 2005, prej ish-bashkëpronareve të apartamentit (nëna dhe motrat), pas blerjes, i është falur (dhuruar) vlera e blerjes së pjesës së tyre në shumën 200.000 lekë. Subjekti ka paraqitur kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 20.1.2005, me palë shitëse S., R.A. (Sh.), I.L. (Sh.), L. (Sh.) Sh. dhe E.S. (Sh.) dhe palë blerëse Alfred Shehu, bashkëpronarë të apartamentit, deklarojnë se sipas marrëveshjes së tyre çmimi i shitjes së pjesëve përkatëse të kësaj pasurie është në vlerën 200.000 lekë, shumë e cila është likuiduar tërësisht nga pala blerëse te pala shitëse, jashtë zyrës noteriale.

**35.** Nga hetimi rezultoi se me anë të procesverbalit, datë 25.1.2016, subjekti është pyetur nga ILDKPKI-ja se përse është dhuruar kjo shumë dhe si mund të vërtetohet. Subjekti ka deklaruar se duke qenë se nëna e tij është në certifikatë familjare me të dhe jeton me familjen e tij, motrat i kanë dhuruar pjesën takuese që kanë përfituar nga shitja si respekt ndaj kujdesit dhe investimit për nënën e tyre. Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar se për këtë dhurim nuk është mbajtur asnjë dokument dhurimi për shkak të lidhjeve familjare.

Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka paraqitur dokument ligjor justifikues për të provuar dhurimin dhe kohën në të cilën është dhuruar shuma prej 200.000 lekë.

**36.** Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar shitjen e këtij apartamenti në shumën 3.438.400 lekë, me kontratën nr. \*\*\*, datë 18.4.2013, po ashtu, DPPPP-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 4.1.2020, konfirmon raportimin në emër të subjektit të rivlerësimit në datën 18.4.2013, për shitjen e apartamentit në vlerën 3.438.400 lekë blerësit A.C.

**37.** Referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, ASHK-ja Elbasan<sup>11</sup>, konfirmon se nëna e subjektit, znj. S.Sh., ka pasur në bashkëpronësi pasurinë me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan, me kontratën nr. \*\*\* datë 20.1.2005, kjo pasuri ka kaluar në pronësi të subjektit, më pas, me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 18.4.2013, ka kaluar në pronësi të shtetasit A.C. Sipas kartelës së pasurisë rezultoi se ky apartament është rivlerësuar në shumën 3.428.880 lekë.

**37.1.** Ndërkohë, ASHK-ja Elbasan, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2020, informon se në emër të shtetasit A.H.Sh. (babai i subjektit) figuron pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e llojit apartament. Në këto kushte, Komisioni kërkoi përsëri informacion me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 1.4.2021 dhe në përgjigje ASHK-ja, me shkresën nr. \*\*\*, datë 21.4.2021, sqaron se kartela për pasurinë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, që më herët ka informuar se rezultoi në pronësi të shtetasit A.Sh., është hapur gabimisht, pasi veprimi i referohet pasurisë së regjistruar në vol. \*\*\*, f. \*\*\*. Pasuria nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, është e njëjta pasuri e privatizuar nga kryefamiljari A.Sh. me kontratën e privatizimit, ku janë pasqyruar edhe transaksionet e mëtejshme, si dhe nuk figuron pasuri e regjistruar në pronësi të të ndjerit A.Sh., pjesa e tij është disponuar në favor të trashëgimlënësve.

**38.** Me anë të pyetësorit nr. 2, subjekti u pyet lidhur me vlerën e deklaruar në DIPP-në e vitit 2003 në shumën “4 milionë lekë”, e ndryshme nga vlera në kontratën e privatizimit. Në përgjigje<sup>12</sup>, subjekti shpjegon se vlera e deklaruar prej tij është vlera që do të kërkonte nëse kjo

---

<sup>11</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 9.10.2017.

<sup>12</sup>E-mail datë 12.3.2021, ora 13:45.



pasuri do të shitej. Gjithashtu, referuar materialit të përcjellë me shkresën nr. \*\*\*, datë 11.3.2021, nga ILDKPKI-ja rezulton se subjekti i vlerësimit ka deklaruar në datën 9.11.2006, se lidhur me deklarin e bërë për këtë pasuri të përfitur me privatizim, vlera e përcaktuar prej tij përkon me vlerën e tregut të kësaj banese në qoftë se nga bashkëpronarët në ato momente do të kryhej ndonjë shitje e mundshme. Më pas, ky apartament është blerë në vlerën 200.000 lekë, vlerë të cilën ish-bashkëpronarët pas blerjes së apartamentit ia kanë dhuruar subjektit dhe aktualisht është në pronësi të tij.

**39.** Lidhur me blerjen e apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup>, datë 20.1.2005, në DIPP-në e vitit 2004, subjekti nuk deklaroi gjendje likuiditetesh *cash* në fund të vitit. Komisioni vëren se të ardhurat gjatë periudhës 1.1.2005 – 20.1.2005, kanë qenë në total në shumën 107.390 lekë, konkretisht, të ardhurat nga paga e subjektit për dhjetorin e vitit 2004 në vlerën 94.990 lekë<sup>13</sup>, të ardhurat nga pensioni i nënës së subjektit në vlerën 12.400 lekë, ndërsa referuar vërtetimit nga ISSh-ja, për bashkëshorten nuk rezultojnë të ardhura nga paga për muajin dhjetor të vitit 2004. Shpenzimet jetike përlllogariten në shumën 36.519 lekë/muaj.

**40.** Sa më lart, diferenca e mundshme për kursim rezulton në shumën 70.871 lekë, e pamjaftueshme për pagesën e vlerës prej 200.000 lekësh dhe, për rrjedhojë, me një balancë negative në shumën 129.129 lekë.

**41. Burimi II – kursimet familjare** - Komisioni vëren se është paguar nga kursimet familjare shuma prej .729.024 lekësh, si diferencë midis çmimit të paguar për blerjen e këtij apartamenti në vlerën 5.167.424 lekë dhe të ardhurave nga shitja e apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup> në vlerën 3.438.400 lekë. Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* nga kursimet familjare dhe dhurata me rastin e lindjes së vajzës në vlerën 700.000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti nuk ka deklaruar pakësime apo shtesa të gjendjes së likuiditeteve *cash*.

**42.** Duke analizuar deklarin e likuiditeteve *cash* prej subjektit, vërehet se deklaroi gjendjen në fund të vitit dhe jo shtesa/pakësime dhe, për rrjedhojë, gjendja e likuiditeteve *cash* duket të ketë qenë në shumën 700.000 lekë në fund të vitit 2012 dhe 0 (zero) lekë në fund të vitit 2013.

**43.** Komisioni kreu analizën financiare në datën 19.4.2013 për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave e lidhur, nga ku rezultoi se: (i) subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare për pagesën e çmimit të apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup> (të cilin ia ka blerë nënës dhe motrave) në shumën 200.000 lekë në datën 20.1.2005 dhe rezultojnë me balancë negative në shumën 129.129 lekë; (ii) subjekti dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime të ligjshme financiare për pagesën e çmimit të apartamentit me sip. 105,2 m<sup>2</sup>, datë 19.4.2013, me një balancë negative në shumën 1.432.697 lekë. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me këto konstatime.

---

<sup>13</sup>Paga për dhjetor 2004, në mënyrë përpjestimore për 1 muaj, referuar totalit të të ardhurave për vitin 2004, sipas vërtetimit nr. \*\*\*, datë 18.1.2017.

**44.** Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet dhe provat me shkrim, si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, lidhur me konstatimin në pikën (i) deklaroi se ka pasur ekonomi të përbashkët familjare me nënën e tij. Bazuar në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe formularët e miratuar nga Inspektori i Lartë i Deklarimit të Pasurive, detyrimin e deklarimit të pasurisë e kanë pasur vetëm bashkëshortët apo fëmijët në moshë madhore të zyrtarit deklarues. Pra, subjekti, pavarësisht deklarimit të të ardhurave të pensionit të nënës së tij në deklaratat periodike vjetore, nuk ka bërë deklarim të mirëfilltë të pasurisë së saj, për shkak se nuk ka qenë subjekt deklarues. Pavarësisht ekonomisë së përbashkët familjare, pjesën më të madhe të të ardhurave të siguruara nga pensioni nëna e tij i ruante si kursime personale. Në këto kushte, balanca negative në shumën 129.129 lekë, për blerjen e apartamentit mbulohet me kursimet e nënës së subjektit.

**44.1** Lidhur me konstatimin në pikën (ii) subjekti deklaroi se në përlllogaritjen e fondeve në datën e lidhjes së kontratës më 19.4.2013, nuk është llogaritur gjendja *cash* në shumën 700.000 lekë, e cila ishte deklaruar si kursim në fund të vitit 2012 dhe që ka shërbyer për blerjen e apartamentit. Subjekti shpjegoi se kursimet *cash* janë pakësuar në këtë datë dhe jo në fund të vitit ashtu siç Komisioni e paraqet në analizën financiare. Më tej, subjekti sqaroi se diferenca e mbetur prej 732.697 lekësh ka si burim kursimet vetjake të nënës nga të ardhurat nga pensioni, të cilat për vitet 2004 – 2012 janë në shumën 1.689.060 lekë, e ardhur kjo shumë më e lartë se diferenca e përlllogaritur nga Komisioni. Si konkluzion, lidhur me shpjegimet e subjektit, të ardhurat e ligjshme të familjes kanë qenë të mjaftueshme për blerjen e apartamentit në datën 19.4.2013.

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**45.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në “Deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratave periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklarinimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

**46.** Në këndvështrim të analizimit të detyrimeve ligjore për të provuar bindshëm ligjshmërinë e krijimit të pasurisë, Komisioni, pasi analizoi deklarinimet dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti, lidhur me pretendimin e subjektit për kursimet e padeklaruara, ndër vite, të nënës së tij, vëren se:

**47.** Bazuar në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, nëna e subjektit nuk ka pasur detyrimin për deklarim në deklaratat periodike ndër vite. Pavarësisht kësaj, duke vërejtur deklaratat periodike Komisioni konstaton se subjekti ka deklaruar rregullisht, ndër vite, të ardhurat e nënës nga pensioni dhe se në të gjitha rastet që subjekti ka deklaruar kursime, ka përdorur termin “familjare”. Për më tepër, gjendja e likuiditeteve *cash* në shumën 400.000 lekë e deklaruar si kursime familjare në fund të vitit 2016, vit në të cilin nëna e subjektit nuk ka pasur detyrim për deklarim, përputhet me shumën e deklaruar në deklaratën *Vetting*, ku nëna e subjektit ka pasur

detyrim për deklaram për efekt të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: *“Deklarimi përfshin pasurinë e subjektit të rivlerësimit dhe familjes së tij bashkëshortit/es dhe fëmijëve në moshë madhore dhe çdo person të përmendur në certifikatën familjare, bashkëjetuesit/es ...[...].*

**48.** Sa më lart, konstatohet se subjekti i ka përfshirë kursimet e nënës në deklaramet e tij, ndër vite, dhe, për këtë arsye, Komisioni i gjen të pabazuara pretendimet e tij lidhur me kursimet e padeklaruara, ndër vite, të nënës së tij.

**49.** Për pasojë, subjekti dhe personat e lidhur rezultojnë me balancë negative në vlerën 129.129 lekë në datën 20.1.2005, për blerjen e apartamentit me sip. 70 m<sup>2</sup>, në Elbasan.

**50.** Komisioni çmon se duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit dhe duke vënë në balancë vlerën e kësaj pamjaftueshmërie, në raport me provat e tjera të administruara nga hetimi, kjo mungesë në vlerën 129.129 lekë, nuk mund të kualifikohen në asnjë prej situatave të parashikuara në pikat 1 dhe 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, të përbëjnë një shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

**51.** Për sa i përket pretendimit se kursimet cash në shumën prej 700.000 lekësh të deklaruara si kursim në fund të vitit 2012, janë pakësuar në datën e lidhjes së kontratës dhe jo në fund të vitit, pra, më 19.4.2013, datë në të cilën ka blerë apartamentin, Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit janë bindëse për sa kohë që gjendja e likuiditeteve në fund të vitit 2013 ka qenë 0 (zero) dhe subjekti ka deklaruar në seksionin e të dhënave konfidenciale në DIPP-në e vitit 2012, ndër të tjera, se blerja është siguruar nga kursimet familjare ndër vite.

**52.** Lidhur me pretendimin për mbulimin e shumës 732.697 lekë me kursimet e nënës, në vijim të arsyetimit në paragrafin 1.23, Komisioni del në përfundimin se ky pretendim nuk mund të merret në konsideratë dhe në analizën financiare të datës 19.4.2013 duhet të konsiderohet vetëm pakësimi i gjendjes së likuiditeteve *cash* në vlerën 700.000 lekë, sikundër ka pretenduar subjekti i rivlerësimit.

**53.** Në përfundim, balanca negative në datën 19.4.2013 është në vlerën 732.697 lekë, duke u gjendur në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme.

## **2. Automjet tip “Alfa Romeo”, me targa \*\*\*, në vlerën 100.000 lekë**

**54.** Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar – automjet tip “Alfa Romeo”, vit prodhimi 2000, me targa \*\*\*, blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 8.11.2016. Vlera: 100.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Si burim krijimi subjekti deklaron kursimet familjare. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>14</sup>.

**55. Faktet nga hetimi administrativ kryesisht** - në deklaratën *Vetting* subjekti ka dorëzuar kontratën nr. \*\*\*, datë 8.11.2016, me palë shitëse shtetasin E.H. dhe palë blerëse subjektin e rivlerësimit. Referuar dokumentacionit të administruar nga DRSHTRR-ja<sup>15</sup>, konfirmohet se subjekti i rivlerësimit ka në statusin e çregjistrimit të përhershëm automjetin me targa \*\*\* dhe ka në pronësi automjetin me targa \*\*\*. Me anë të vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 25.5.2018, të Drejtorisë Rajonale Elbasan, automjeti tip “Alfa Romeo” është hequr nga qarkullimi

<sup>14</sup>Kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 8.11.2016, leje qarkullimi e automjetit me targa \*\*\*.

<sup>15</sup>Shkresaë nr. \*\*\* prot., datë 24.12.2019.

përfundimisht në datën 28.5.2018, për arsye “jashtë përdorimi”, me kërkesë të subjektit, deklaruar sa më lart edhe në DIPP-në e vitit 2018. Ky automjet është blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 8.11.2016, me palë shitëse E. H. dhe palë blerëse Alfred Shehu, në vlerën 100.000 lekë.

**55.1.** Sipas dokumentacionit të përcjellë, rezultojnë policat e sigurimi për periudhat 16.9.2014 - 15.9.2015 dhe 4.10.2016 – 3.10.2017, ku subjekti i rivlerësimit figuron si përdorues i këtij automjeti. Ndërkohë, nga kontrolli në AMF, rezulton se policat e sigurimit për këtë automjet është prerë në emër të subjektit për periudhën 6.10.2017 – 5.10.2018.

**56.** Sa më sipër, rezulton se subjekti nuk ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti në DIPP-të e viteve 2014, 2015 dhe janar – nëntor 2016<sup>16</sup>.

**57.** Komisioni kreu analizën financiare në datën 8.11.2016, duke konsideruar të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e subjektit dhe personave të lidhur për periudhën 1.1.2016 - 6.11.2016, për sa kohë subjekti nuk ka deklaruar pakësimin e gjendjes së likuiditeteve *cash* në DIPP-në e vitit 2016 dhe rezultoi se kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit tip “Alfa Romeo” dhe kryerjen e shpenzimeve deri më 8.11.2016.

**58. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës,** Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar përdorimin e automjetit “Alfa Romeo” në DIPP-të e viteve 2014, 2015 dhe janar – nëntor 2016, ku sipas policave të sigurimit figuron përdorues i këtij automjeti.*

**59. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim si dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës,** deklaroi se shtetasi E. H. është kunati/vëllai i bashkëshortes së tij dhe është pronari i automjetit tip “Alfa Romeo”, me targa \*\*\*. Subjekti e ka përdorur rrallë këtë automjet dhe jo për periudha të gjata kohore, vetëm për nevoja urgjente familjare. Për shkak të mundësisë së përdorimit në raste urgjente, kunati i tij ka vlerësuar që policat e sigurimit të pritej edhe në emër të subjektit, për të qenë i siguruar ligjërisht për çfarëdolloj përgjegjësie ndaj palëve të treta. Subjekti deklaroi se kjo ka qenë një marrëdhënie reciproke dhe se policat e sigurimit për automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\*, në disa raste janë prerë, përveçse në emrin e tij si pronar i këtij automjeti edhe në emër të kusetërve të tij E. H. e M. H. për të qenë gjithmonë të siguruar ndaj palëve të treta, në rast përdorimi nga ana e tyre.

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

**60.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratat e subjektit të rivlerësimit në “deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*”; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratat në seancë dëgjimore, arsyeton se:

---

<sup>16</sup>Policat e sigurimit është prerë në datën 4.10.2016, ndërkohë që automjeti nga subjekti është blerë në datën 8.11.2016.

**61.** Subjekti i rivlerësimit mbart detyrimin të deklarojë pasuritë e luajtshme dhe të drejtat reale mbi to sipas Kodit Civil, bazuar në germën “b”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar. Referuar nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, “Pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 më sipër, që janë në pronësi, zotërim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit.

**62.** Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë për përdorimin e këtij automjeti në vitet 2014, 2015 dhe janar - nëntor 2016, por duke qenë se në lidhje me ligjshmërinë e burimit të krijimit, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë pasur mundësi financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, kjo pasaktësi në deklarim nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi për subjektin e rivlerësimit.

**63. Automjete të tjera** - në DIPP-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\*, vit prodhimi 1995, me kontratë nr. \*\*\*, datë 6.11.2007. Vlera: 400.000 lekë. Burim krijimi: kursimet familjare. Pjesa takuese: 100 %.

**63.1.** Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar nxjerrjen jashtë përdorimi të automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\*, provuar kjo me vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 13.5.2014, të Drejtorisë Rajonale të Transportit Rrugor Elbasan. Sipas materialit të përcjellë nga ILDKPKI-ja, me shkresën nr. \*\*\*, datë 11.3.2021, me vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 13.5.2014, ky automjet është hequr nga qarkullimi me kërkesë të subjektit.

**64.** Referuar dokumentacionit të administruar nga DRSHTRR-ja<sup>17</sup>, subjekti i rivlerësimit ka në statusin e çregjistrimit të përhershëm automjetin me targa \*\*\*. Sipas kontrollit në AMF, rezulton se policia e sigurimit është prerë në emër të subjektit për periudhën 9.9.2008 – 8.9.2014.

**65.** Komisioni kreu analizën financiare në datën 6.11.2007, duke konsideruar të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë për periudhën 1.1.2007-6.11.2007 dhe rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, si dhe për kryerjen e shpenzimeve deri më 6.11.2007.

### **3. Gjendje *cash*, në vlerën 400.000 lekë**

**66.** Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* në vlerën 400.000 lekë, në bashkëpronësi. Burim krijimi: kursimet familjare.

**67.** Komisioni konstatoi se deklaratimet e subjektit ndër vite, lidhur me likuiditetet *cash*, përputhen me deklarimin e tij në deklaratën *Vetting* dhe se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e kursimeve *cash*, në shumën 400.000 lekë.

### **Analiza financiare**

---

<sup>17</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.12.2019.

**68.** Lidhur me shpenzimet e mobilimit, në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar se mobilimi i banesave është kryer, ndër vite, në vazhdimësi dhe se vlera e tyre nuk e ka kaluar vlerën e deklarimit të detyrueshëm për çdo vit kalendarik. Në pyetësin nr. 2, subjekti deklaroi se nga llogaritjet e kryera përafërsisht shuma totale e shpenzimeve të tilla qëkur ka filluar punë si oficer i policisë gjyqësore deri në fund të vitit 2016, ka qenë 700.000 lekë

**69.** Në këto kushte, duke marrë në konsideratë kohën e blerjes së apartamenteve, periudhën në të cilën subjekti ka banuar në to dhe sipërfaqen e secilit apartament, Komisioni vlerësoi që në analizën financiare të pasqyrojë shumën 200.000 lekë për periudhën 2000 – 2003 dhe shumën 500.000 lekë të ndarë në 2 vite, përkatësisht 2013 dhe 2014.

**70. Në përfundim,** Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për periudhën 2000 – 2016, dhe rezultoi se kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën në kursime.

### **Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë**

**71.** Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, me veprimet dhe mosveprimet e tij, nuk ka cenuar besimin e publikut.

**72.** Komisioni, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e mungesës së burimeve të ligjshme për shumën 816.826 lekë, por edhe faktin që personi i lidhur nëna e subjektit mund të ketë pasur kursime, të cilat nuk janë deklaruar nga subjekti, në raport me provat e tjera të administruara, nëpërmjet hetimit, trupi gjykues vlerëson se kjo mungesë nuk mund të përbëjë e vetme shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

**73.** Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Shehu, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

### **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**74.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin fillestar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, ku është konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës.

**75.** Në vazhdim, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.4.2021, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.4.2021, të KDZH-së, është përcjellë raporti vijues për kontrollin e figurës, me përgjigjet e autoritetit verifikues. Konkretisht, nga informacioni i ardhur rezultoi se: “... për shtetasin Alfred A. Shehu disponohen të dhëna për veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës. Institucionet verifikuese për subjektin e rivlerësimit Alfred

Shehu kanë ndarë disa informacione me organet ligjzbatuese mbi veprimtari të kundërligjshme në sistemin e drejtësisë në Elbasan, ku informohet se shtetasi Alfred Shehu, me detyrë prokuror i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, kundrejt mitës ka mundësuar favorizimin e një shtetasi pasaporta e të cilit, ndër të tjera, ishte sekuestruar nga strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan.

**76.** Në përfundim, Grupi i Punës nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ndryshon konstatimin fillestar të dhënë për subjektin e rivlerësimit, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit Alfred A. Shehu.

**77.** Në sajë të *indicieve* të marra nga raportet e DSIK-së, për të verifikuar më tej figurën e subjektit, Komisioni analizoi dokumentacionin e administruar nga Prokuroria e Përgjithshme<sup>18</sup> në lidhje me ankesat e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit dhe masat disiplinore të marra ndaj tij, nga viti 2006 e deri më sot, si dhe kërkoi informacion pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan<sup>19</sup> lidhur me procedimet penale të referuara. Pasi u analizuan fashikujt penalë të procedimit nr. \*\*\*, të vitit 2017<sup>20</sup>, Komisioni konstatoi se në vlerësim të fakteve të paraqitura nuk rezultuan *indicie* për hetime të mëtejshme ndaj subjektit të rivlerësimit.

**78. Sa më sipër,** nga hetimi i Komisionit në lidhje me raportin e organeve verifikuese, u konstatua se të dhënat e paraqitura nuk përputhen me situatën faktike të dosjes penale përkatëse dhe nuk rezultuan veprime apo mosveprime të subjektit të rivlerësimit, të cilat konfirmojnë informacionin e përcjellë nga organet verifikuese.

**79.** Subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016, nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

### **Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës**

**80.** Nga hetimi administrativ i Komisionit nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është i përfshirë, si dhe nuk është i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

**81.** Në përfundim të hetimit administrativ, të vlerësimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikës 15 të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Shehu, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

## **C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

<sup>18</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2020.

<sup>19</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.4.2021.

<sup>20</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.4.2021, e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

**82.** Subjekti i rivlerësimit Alfred Shehu, në datën 27.2.1996, është emëruar oficer i policisë gjyqësore, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Me Dekretin nr. \*\*\*, datë 21.12.1999, të Presidentit të Republikës, subjekti është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh. Në datën 4.9.2007 është emëruar prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Në periudhën 20.10.2010 – 14.03.2016 është emëruar zëvendës drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

**83.** Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rregulloren “Për vlerësimin etik e profesional të subjekteve në proces rivlerësimi” ka miratuar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike për përshkrimin dhe analizën e dokumenteve të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit Alfred Shehu. Nga vlerësimi i tri dokumenteve të përzgjedhura nga subjekti, pesë dosjeve të përzgjedhura me short, sipas ligjit nr. 96/2016, si dhe burimeve arkivore të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme, janë vënë re këto gjetje:

#### **84. Aftësitë profesionale**

*Njohuritë ligjore* – subjekti i rivlerësimit Alfred Shehu shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit dhe identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme. Nga dosjet e vëzhguara konstatohet se ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastin konkret. Kështu, menjëherë, pasi urdhëron regjistrimin e procedimit, subjekti i rivlerësimit përcakton detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore, duke i përshkruar konkretisht se çfarë duhet të kryejë dhe duke i vendosur afatin e kryerjes së tyre.

*Arsyetimi ligjor* - subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetim ligjor, bën analizë të saktë mbi rrethanat e faktit dhe provave të mbledhura, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore.

#### **85. Aftësitë organizative**

*Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë* – sipas të dhënave rezulton se, për periudhën e punës si prokuror, subjekti ka trajtuar 998 çështje. Nga dosjet e vëzhguara rezulton se subjekti është i kujdesshëm në kryerjen e veprimeve hetimore në dinamikë dhe në respektim të afateve ligjore të kërkuara, duke i dhënë një zgjidhje të shpejtë çështjeve të trajtuara. Subjekti ka treguar aftësi të mira në organizimin efektiv të kohës së punës, e lidhur kjo me kohën e përfundimit të çështjeve të analizuara dhe numrit total të çështjeve të përfunduara, për të gjithë periudhën e vlerësimit.

*Aftësia për të kryer procedurat hetimore/gjyqësore* – rezulton se veprimet procedurale hetimore të kryera nga subjekti i rivlerësimit janë produktive, veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat dhe aktet e nevojshme, si dhe duke konkluduar në një vendim marrje. Lidhur me njoftimet e vendim marrjeve konstatohet se është respektuar detyrimi për të kryer njoftimet përkatëse të palëve. Gjithashtu, vihet re se qëndrimi i prokurorit në seancë gjyqësore është korrekt dhe etik, duke shprehur qëndrimin e tij të arsyetuar ligjor lidhur me çështjet objekt gjykimi.



*Aftësia për të administruar dosjet* – subjekti ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve dhe rregullsisë së akteve. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara, të strukturuar dhe në respektim të normave të drejtshkrimit. Dosjet për gjykim konstatohet se ndodhen të administruara, konkluzionet me shkrim të paraqitura në gjykatë, duke e bërë qartësisht të lexueshme zgjidhjen e çështjes.

#### **86. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

*Etika në punë* – nga aktet e përzgjedhura nga subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

*Integriteti* – nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit si dhe nga dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

*Paanësia* – nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit dhe nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar.

#### **87. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

*Aftësitë e komunikimit* – vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë. Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t'u angazhuar, subjekti Alfred Shehu rezulton se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, të cilat janë përshkruar më sipër.

Në vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit për vitet 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016, nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se për aftësitë profesionale në cilësinë e prokurorit, është vlerësuar “shumë mirë”.

#### **Të dhënat arkivore lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime**

**88.** Nga verifikimi në arshivën e Prokurorisë së Përgjithshme rezulton që ndaj subjektit Alfred Shehu nuk është dhënë asnjë masë disiplinore. Bazuar në përgjigjet e ardhura nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, rezulton se:

**89.** Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, më 22.7.2016, është regjistruar materiali kallëzues nr. \*\*\*, i vitit 2016, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ky kallëzim penal është regjistruar mbi bazën e kallëzimit të shtetasit J.T. Kallëzuesi J.T., me banim në qytetin Elbasan, ka paraqitur kallëzim penal kundër disa prokurorëve dhe gjyqtarëve të Elbasanit në lidhje me pretendimin e tij se disa vendime të dhëna kanë qenë të padrejta dhe, për këtë fakt, ai i ka konsideruar këto veprime si veprime në shpërdorim të detyrës.

**90.** Kallëzimi konsiston ndaj një vendimi të datës 12.10.2007, ku Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, ka vendosur “mosfillimin e hetimeve”. Kallëzuesi ka pasur disa konflikte në vite me shtetasin D.Q., vendime të cilat datojnë në vitet 2010 dhe 2011. Ky shtetas ka paraqitur kallëzim kundër vendimeve të dhëna nga prokurori Alfred Shehu, gjyqtarët B.M., I.P., etj. Në kuadër të verifikimeve paraprake nga ana e organit procedues janë marrë si provë vendimet e dhëna ndër vite të administruara në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Elbasan. Nga ky verifikim rezulton se kallëzuesi J.T., kundër vendimeve të marra nga kjo prokurori, nuk ka ushtruar të drejtën e ankimit, si dhe pa konsumuar këtë të drejtë dhe pa asnjë provë tjetër ka paraqitur kallëzimin penal për shpërdorimin e detyrës së prokurorëve dhe gjyqtarëve. Nga verifikimet e kryera dhe të dhënat e grumbulluara, Prokuroria Tiranë vlerëson se ekzistojnë shkaqe ligjore që duhet të vendoset mosfillimi i procedimit.

**91.** Nga analiza e fakteve dhe rrethanave të mësipërme arrihet në konkluzionin se pretendimi i kallëzuesit në lidhje me faktin se të kallëzuarit kanë konsumuar veprën penale “shpërdorim detyrë”, nuk përmban elementët minimalë për të filluar një procedim penal. Vendimet për të cilat pretendon kallëzuesi janë të ankimueshme, rrugë e cila nuk është ndjekur prej tij. Në këto kushte, prokuroria nuk mund të konkludonte se veprimet e kryera nga prokurorët apo gjyqtarët që ushtrojnë kompetencat e tyre në rrethin e Elbasanit dhe kanë shqyrtuar kërkesat e kallëzuesit, janë kryer në kundërshtim me ligjin. Për këto arsye, në mbështetje të germës “g”, të nenit 290/1 dhe nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, Prokuroria Tiranë vendosi *“Mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. \*\*\*, të vitit 2015, pasi fakti i kallëzuar nuk përbën veprë penale”*.

**92.** Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, më 24.7.2018, është regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\*, mbi bazën e kallëzimit penal të bërë nga shtetasi B.I., për veprën penale “shpërdorim detyrë”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Nga përmbajtja e materialit kallëzues, shtetasi B.I. pretendon se nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan është akuzuar dhe më 13.2.2015 ka dërguar për gjykim çështjen penale në ngarkim të tij për veprat penale të parashikuara nga nenet 245/1/2, 246/1/2, 186/2 dhe 190/1 të Kodit Penal.

**93.** Kallëzuesi pretendon se, fillimisht, në gjyq si përfaqësues i organit të prokurorisë është paraqitur prokurori B.M. për të cilin pretendon se me shumë vështirësi e ka përjashtuar dhe është zëvendësuar me prokuroren A.Xh. Edhe për prokuroren A.Xh. kallëzuesi ka kërkuar përjashtimin dhe ajo është zëvendësuar me prokurorin F.L., i cili gjatë procesit të gjyqimit është transferuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Pas prokurorit F.L., si përfaqësues i akuzës në gjykim është caktuar prokurori Alfred Shehu, që kallëzuesi pretendon se ka pasur konflikte të vjetra dhe në këto rrethana ka kërkuar përjashtimin e tij dhe në vendin e tij është caktuar prokurori A.B. Gjithashtu, kallëzuesi pretendon se me këtë prokuror nuk ka pasur asnjëherë mosmarrëveshje, por pretendon se ai ka mbajtur të njëjtin qëndrim si prokurorët e përjashtuar. Në këto kushte pretendon se ka kërkuar përjashtimin e tre prokurorëve të parë, me qëllim për të pasur një hetim sa më të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes. Gjithashtu, kallëzuesi pretendon se diskutimi përfundimtar është përgatitur krejtësisht në bashkëpunim me tre prokurorët e parë të përjashtuar prej tij B.M., A.Xh. dhe Alfred Shehu, ndërsa prokurori A.B. e ka firmosur dhe e ka dorëzuar në gjykatë. Ky fakt pretendohet se është i verifikueshëm po të krahasohet kërkesa për gjykim me diskutimet përfundimtare ku mbi 80% e fakteve janë të njëjta.

**94.** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë arrin në përfundimin se nuk plotësohen elementët e veprës penale “shpërdorim detyrë”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi nuk ekzistojnë veprime apo mosveprime të kundërligjshme të kryera nga të kallëzuarit, në kundërshtim me ligjin dhe rregullat, të cilat normojnë funksionin e tyre. Nga aktet e administruara rezulton se përfaqësimi në gjykim nga prokurori i seancës është në

përputhje me ligjin dhe nëse kallëzuesi do të kishte pretendime në lidhje me hetimin dhe gjykimin duhej t'i drejtohej gjykatës gjatë gjykimit të çështjes, duke parashtruar këto pretendime dhe është gjykata i vetmi organ kompetent kushtetues që bën vlerësimin e fakteve dhe disponon me vendim përkatës. Bazuar në nenin 290, në germën “ç”, të nenit 291, të Kodit të Procedurës Penale, Prokuroria Tiranë vendosi “*Mosfillimin e materialit kallëzues me nr. \*\*\*, datë 24.7.2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal*”.

**95.** Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është dërguar edhe kallëzimi penal nr. \*\*\*, i vitit 2020, regjistruar në këtë prokurori më 6.7.2020. Nga shqyrtimi i akteve të këtij kallëzimi, bëhet fjalë për një djegie aksidentale të një automjeti që është në pronësi të shoqërisë “\*\*\*”, administrator i së cilës është shtetasi me gjeneralitete Alfred Shehu. Ky person nuk ka lidhje me subjektin e rivlerësimit Alfred Shehu, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

**96.** Në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme janë gjetur këto ankesa në të cilat përmendet edhe prokurori i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Alfred Shehu.

**97.** Ankesë nga shtetasi F.P., nënshkruar edhe nga shtetasi B.I., protokolluar me nr. \*\*\* prot., datë 21.9.2018, në Prokurorinë e Përgjithshme. Ky shtetas pretendon se në vitin 2008 i janë vjedhur materialet që kishte në magazinën e privatizuar prej tij. Ai pretendon se një nga personat që e kishte vjedhur është djali i motrës së prokurorit Alfred Shehu, i cili ka ndikuar që të mbyllej çështja për vjedhje duke mos i zbuluar autorët. Më shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.11.2018, këtij shtetasi i është kthyer përgjigje nga Prokuroria e Përgjithshme se pas ndryshimeve ligjore kjo prokurori nuk ka më kompetencë të ndërhyjë në vendimmarrjen e prokurorëve.

**98.** Ankesë nga shtetasja A.S., protokolluar me nr. \*\*\*, datë 30.11.2017, në Prokurorinë e Përgjithshme. Në mënyrë të përsëritur, kjo shtetase është ankuar ndaj vendimmarrjes së Prokurorisë Elbasan, e cila ka vendosur mosfillimin e kallëzimit penal të bërë prej saj. Në ankesë përmendet edhe prokurori Alfred Shehu. Në mënyrë të përsëritur Prokuroria e Përgjithshme i ka kthyer përgjigje kësaj shtetaseje se vendimmarrja e prokurorit shqyrtohet në gjykatë dhe se Prokuroria e Përgjithshme nuk ka më kompetencë ligjore për të ndërhyrë në vendimmarrjen e prokurorit.

**99.** Ankesë nga shtetasi A.T., protokolluar me nr. \*\*\*, datë 6.2.2018, në Prokurorinë e Përgjithshme, në të cilën ky shtetas ankohet se për një kallëzim të bërë nga ana e tij më 11.10.2010 prokurori Alfred Shehu nuk ka zbuluar autorët e vjedhjes që i është bërë atij. Ankuesi kërkon që të hapet përsëri çështja e tij, ku i është dëmtuar prona. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.3.2018, këtij shtetasi i është kthyer përgjigje nga Prokuroria e Përgjithshme, se pas ndryshimeve ligjore kjo prokurori nuk ka më kompetencë të ndërhyjë në vendimmarrjen e prokurorëve.

**100.** Ankesë nga shtetasi B.I., protokolluar me nr. \*\*\* prot., datë 23.8.2018, në Prokurorinë e Përgjithshme. Në ankesën e tij ky shtetas kërkon zëvendësimin e prokurorit Alfred Shehu nga hetimi i çështjes, ku ky ankues është i akuzuar. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.4.2018, këtij shtetasi i është kthyer përgjigje nga Prokuroria e Përgjithshme se pas ndryshimeve ligjore kjo prokurori nuk ka më kompetencë të ndërhyjë në vendimmarrjen e prokurorëve. Gjithashtu, i

është bërë me dije se baza ligjore, e cila është përdorur për të kërkuar zëvendësimin e prokurorit nga personi i marrë si i pandehur, nuk qëndron.

**101.** Ankesë nga shtetasi F.K., përfaqësues i shoqërisë “\*\*\*\*”, protokolluar me nr. \*\*\* prot., datë 15.6.2016, në Prokurorinë e Përgjithshme. Nga ana e tij kërkohet shfuqizimi i vendimit të mosfillimit të prokurorit Alfred Shehu i datës 26.5.2017. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.6.2016, këtij shtetasi i është kthyer përgjigje nga Prokuroria e Përgjithshme, se pas ndryshimeve ligjore kjo prokurori nuk ka më kompetencë të ndërhyjë në vendimmarrjen e prokurorëve dhe se ankimi i tij duhet të ndjekë rrugën gjyqësore.

**102.** Në lidhje me vlerësimet e punës së subjektit Alfred Shehu, për vitet 2013 – 2016, të Prokurorit të Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**103.** Komisioni, me shkresën nr. \*\*\*, datë 12.10.2020, kërkoi informacion nëse ka të regjistruar procedim penal, mosfillim ose pushim në ngarkim të subjektit të rivlerësimit. Pas administrimit të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 16.12.2020, nga Prokuroria e Përgjithshme, rezutoi si vijon:

**104.** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>21</sup> bën me dije se është regjistruar materiali kallëzues nr. \*\*\* ndaj shtetasve Alfred Shehu dhe D.B., mbi bazën e kallëzimeve të shtetasve P. e A.M. dhe F.H., ardhur për kompetencë nga Prokuroria e Tiranës, protokolluar më 29.1.2008 dhe në datën 30.1.2008 është kthyer përsëri në Prokurorinë e Tiranës.

**105.** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>22</sup> informon se ndaj subjektit të rivlerësimit është regjistruar: (i) kallëzimi penal nr. \*\*\* për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit J.T. Për këtë kallëzim në datën 7.11.2016, është vendosur mosfillimi i hetimeve; (ii) kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë 24.7.2018, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit B.I. Për këtë kallëzim, në datën 31.7.2018, është vendosur mosfillimi i hetimeve.

**106. Në përfundim,** Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e depozituara në Prokurorinë e Përgjithshme, vlerëson se nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

### **Konkluzione për rivlerësimin e aftësive profesionale**

**107.** Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv, si dhe konsiderohet “i aftë”.

**108.** Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Shehu, ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

## **DENONCIMET NGA PUBLIKU**

---

<sup>21</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.7.2020.

<sup>22</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.7.2020.

**109.** Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Alfred Shehu janë administruar 10 denoncime nga publiku. Në 9 prej këtyre denoncimeve ngrihen pretendime për dhënien e vendimeve të padrejta dhe nuk përmbahen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit të subjektit, respektivisht: (1) denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2018, i shtetasës N. Z., e cila ankohet për për 11 subjekte rivlerësi, ndër ta edhe për subjektin Alfred Shehu, për dhënien e disa vendimeve të padrejta; (2) denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2018, i shtetasit P. B., i cili ankohet lidhur me mosfillimin e procedimit penal dhe mosnjoftimin e vendimit të mosfillimit; (3) denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 26.2.2018 dhe nr. \*\*\* prot., datë 10.7.2018, të shtetasit O.T., i cili ankohet për disa subjekte rivlerësi, ndër ta edhe për subjektin Alfred Shehu për dhënien e vendimeve të padrejta dhe ushtrim presioni ndaj tij; (4) denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 24.11.2019, i shtetasit B. I., lidhur me mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*; (5) denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 24.9.2018, i shtetasit F. P., ku nuk është paraqitur ndonjë pretendim konkret dhe material provues ndaj subjektit të rivlerësimit; (6) denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 15.11.2019, i shtetasës A. S., e cila ankohet lidhur me pushimin e procedimit penal nr. \*\*\* dhe moshetimin e kallëzimit të saj nga subjekti i rivlerësimit; (7) denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 10.8.2020, i shtetasve F. B. dhe B. I., të cilët ankohen për dhënien e një vendimit të padrejtë.

**110.** Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e mësipërme konstaton se pretendohen fakte që kanë lidhje me korrektësinë e vendimeve dhe themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, fjalia e fundit, faqja 60 nga 64 e Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

**111.** Ndërkohë që, lidhur me denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 8.3.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 28.5.2019, të paraqitura nga shtetasja V. K., e cila ankohet lidhur me mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 15.2.2019, Komisioni kërkoi shpjegime apo prova pasi konstatoi se: *Vendimi për mosfillimin e procedimit penal nr. \*\*\*, datë 15.2.2019, dhënë nga subjekti në datën 22.2.2019, është disponuar tej afatit procedural 15-ditor, i parashikuar në pikën 1, të nenit 291, të Kodit të Procedurës Penale.*

**112. Subjekti paraqiti shpjegimet, duke sqaruar se** sipas praktikës pasi materiali kallëzues regjistrohet në protokollin e Prokurorisë, kalon te Drejtuesi i Prokurorisë, i cili kryen shënimet e nevojshme dhe materiali regjistrohet në regjistrin e njoftimit të veprave penale dhe kallëzimeve penale. Më pas, hidhet në short dhe caktohet prokurori përkatës, i cili njoftohet për të tërhequr materialin hetimor pranë zyrës së regjistrit. Brenda 15 ditësh, pasi kallëzimi apo materiali hetimor regjistrohet në regjistrin e njoftimit të veprave penale dhe kallëzimeve penale, prokurori i caktuar duhet të vendosë mosfillimin e procedimit ose duhet të urdhërojë regjistrimin e procedimit penal dhe vazhdimin e hetimeve. Në kuptim të pikës 1, të nenit 291, të Kodit të Procedurës Penale, afati 15-ditor lind që në momentin e regjistrimit të materialit hetimor apo kallëzimit penal në regjistrin e njoftimit të veprave apo kallëzimeve penale, si dhe pas caktimit të këtij materiali hetimor me short elektronik. Gjatë 15 ditëve, prokurori kur

konstaton se materiali hetimor i referuar nga policia gjyqësore apo kallëzimi penal i regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale dhe kallëzimeve penale nuk është i plotë, brenda 15 ditëve mund të bëjë dhe vetë verifikime. Në disa raste, kur Drejtuesi i Prokurorisë konstaton se kallëzimet nuk ishin bërë në formën e kërkuar nga ligji apo nuk ishin të qarta për sa i përket ekzistencës së veprave penale, ia dërgon ato shërbimeve të policisë gjyqësore për të thirrur shtetasin kallëzues dhe për të kryer më pas verifikimet përkatëse. Pas kësaj ndiqej procedura e zakonshme e regjistrimit të kallëzimit. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me kallëzimin e shtetasës V. K. Subjekti deklaron se duke qenë se materiali i parë hetimor nuk ishte i plotë ka kërkuar informacion dhe administrimin e praktikave nr. \*\*\* prot., datë 18.2.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2019, të Zyrës Përmbaremore “\*\*\*” Elbasan. Më tej, pasi më parë janë verifikuar rrethanat e parashikuara nga neni 290 i Kodit të Procedurës Penale, janë analizuar pretendimet e paraqitura nga kallëzuesja, duke u ballafaquar me dispozitat procedurale dhe ato penale, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Për të provuar deklaratimet e tij, në cilësinë e provës, subjekti paraqiti të dhënat e printuara nga sistemi CAMS në lidhje me kallëzimin penal nr. \*\*\*, të vitit 2019.

**113. Pasi u analizuan shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, rezultoi se vendimi i mosfillimit është marrë brenda afatit të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale, neni 291 “Vendimi për mosfillimin e procedimit” pika 1, ku përcaktohet se kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit brenda 15 ditëve nga regjistrimi i kallëzimit. Sa rezulton, Komisioni konstaton se në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se këto 2 denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.**

**114. Si konkluzion,** Komisioni, në vlerësimin tërësor të kriterit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Shehu, është “i aftë”, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është eficient në masë të pranueshme.

## **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Shehu, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin dhe referuar germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Alfred Shehu, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 20.5.2021.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Firdes SHULI**  
Kryesuese

**Etleda ÇIFTJA**  
Relatore

**Roland ILIA**  
Anëtar

*Sekretare gjyqësore*  
*Olsida Goxhaj*